



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-
01.Nr. zyrtar/ 2020



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i V-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020

Më 27.10.2020

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Jaser Jaha, zv.Komandant i Policisë-Kaçanik

Përfaqësuesi i FSK-së

Kjani Sallahu, FOJK

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani-Drejtësor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Lirije Luta- Komiteti për Komunitete

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Fidaim Fazliu-Bashkësia Islame

Fadil Guri -ZKKK

Vedat Dema-Zyra për Barazi Gjinore

Me arsyetim mungoi Drejtori i DAK(Koordinator i KKSBB) Zahir Doda

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut z. **Besim Ilazi**, i cili prezantoi pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Përgatitje për sezonin e dimrit
4. Të ndryshme

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës zv. **Komandanti i Policisë** tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile.

Gjatë kësaj periudhe kohore nga mbledhja e kaluar e deri më sot i kemi të evidentuar gjithsejtë 35 raste të ndryshme si në dëmtime kriminale aksidente trafiku dhe dukuri të vjedhjeve . Ne jemi duke u angazhuar në zbatimin e masave të vendosura nga IKSHP dhe për këtë kemi një plan veprimi mbi pandeminë . Bartja e maskave është obligative dhe ata persona janë zënë pa maska janë gjobitur .Asistimi ynë ka qenë edhe me inspektorët sanitare të nivelit qendrorë por edhe të nivelit lokal .Deri më tash kemi të evidentuar 116 raste pozitive me virus COVID-19 , 608 persona që kanë kaluar në procedurat e izolimit dhe 10 raste të vdekjes nga ky virus.

Kryetari: Falënderojmë zv. Komandantin për këtë raport .Situata në nivel vendi është alarmuese me shtim të rasteve ndërsa në komunën tonë është një komoditet por që duhet marrë masa paraprake . Edhe nga ky takim ne mundë të apelojmë tek qytetarët për respektim të masave të ndërmarrura nga IKSHP . Zyrtarisht në komunën tonë kemi dy raste aktive në katër javët e fundit .

K.Sallahu: më intereson të dijë se a janë të furnizuar shkollat me material hixheniko-sanitar dhe si është situata në përgjithësi nëpër shkolla .

Kryetari :Në komunën tonë siç jeni të informuar kemi të formuar TASK-FORC-ën dhe për çdo javë ne mbledhim informacione nga TASK—FORC-at e formuara nëpër shkolla dhe japim udhëzime për javën në vijim .Deri më tani nuk kemi pasur ndonjë

rast të infekzionit pos dy raste të dyshuara në shkollën fillore „Ali Asllani” -Doganaj dhe në shkollën fillore në fshatin Elezaj , ku janë testuar personat e dyshimitë dhe fatmirësisht kanë dalë negativ . Ne si komunë kemi kontraktuar një kompani e cila bën dezinfektimin e hapësirave të brendshme të shkollave por që shkollat i kemi pajisur edhe me pompa dore që gjatë ditës dezinfektohen klasat . Në përgjithësi situata është nën kontrollë por që kujdes duhet të kemi pasi që kemi hyrë në një stinë ku prezent do ta kemi edhe gripin sezonal .

R.Osmani: Si dihet kohëve të fundit si top-prioritet policia i ka dhënë gjobave për mos vendosjen e maskave nga qytetarët e shqetësim mendoj që është edhe aksidentet në komunikacion që po bëhen sidomos në zonat urbane. Më intereson të dijë se sa është funksional sektori i trafikut dhe a do të ishte mirë që policia të pajiset me radarë me qëllim që të ulen rastet e aksidenteve sidomos në zonat urbane , ngase disa vozitës të pandërgjegjshëm nuk po i respektojnë shenjat e komunikacionit Ne si komunë kemi marrë masa në vendosjen e barrierave afër shkollave por e kemi të pamundur të vendosim në çdo rrugë . Krahas masave mbi pandeminë , nuk duhet anashkaluar edhe veprat tjera kundërvajtëse siç janë prerja e pyjeve , vjedhjet etj .

J. Jaha: Ne si stacion i polisë nuk kemi njësi të veçantë të trafikut ngase ky njësit është në kuadër të regjionit . Është e vërtetë se orientimi ynë kohëve të fundit është në parandalimin e pandemisë por që nuk kemi lënë anash angazhimin edhe në parandalimin e veprave tjera kundërvajtëse . Kemi rritje të aksidenteve me dëme të vogla por që qytetarët nuk i lajmërojnë këto raste dhe ata me ndonjë marrëveshje për mbulim të dëmeve nga kompanitë e sigurimeve , problemin po e zgjedhin aty për aty . Sa i përket radarëve në kohën kur në autostradë ka operuar BECHTELENKA , e kemi huazuar një prej tyre por që për momentin nuk posedojmë .

K.Sallahu: më intereson të dijë për procesverbalet se a janë duke u publikuar në faqen e komunës .

F.Qaka:pas miratimit të procesverbaleve në KKSB unë menjëherë i përcjelli tek zyrtari i IT-së dhe mendoj se procedurën e publikimit ata e kanë kryer .

K.Sallahu: u përmendë si kërkesë për vendosjen e barrierave nëpër disa rrugë që mendoj se është kërkesë e arsyeshme por që shohim se është edhe një negligencë e veprimeve të organeve të rendit që nuk po janë mjaftë këmbëngulës në zbatimin e ligjit . Nëse organet e rendit janë në nivel të detyrës atëherë edhe ne nuk kemi nevojë të investojmë në gjëra të tillë .

Një rol të rëndësishëm në uljen e aksidenteve dhe veprave tjera kundërvajtëse e luajnë edhe kamerat e sigurisë .Mendoj se duhet të krijohet një shprehi në kontrollimin e kamerave të sigurisë nga zyrtarët përgjegjës me qëllim të veprimit sa më të shpejtë ndaj veprimeve kundërvajtëse .

Një çështje tjetër që dua të potencojoj është edhe puna e inspektorëve komunal se sa janë ata në nivel të kryerjes së detyrave që kanë . Në një raport 9 mujorë që kam

lexuar , një sektorë kishte dhënë gjobë 25 euro dhe një tjetër 375 , pra shuma e gjobave është dhënë nga inspektorët komunal ishte 400 euro që për mendimin tim nuk është një punë e mirë që kryhet nga inspektorët .Veprimet e tyre në teren mundë të veldijësojnë qytetarët .

Përgatitje për sezonin e dimrit

Në këtë pikë të rendit të ditës fjala iu dha Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjencia i cili tha se i kemi marrë të gjitha masat përgatitore për sezonin e dimrit . Kemi kontraktuar kompaninë për mbikëqyrje të rrugëve për sezonin verë-dimër .Jemi komod rreth procedurave të prokurimit lidhur me kompaninë e përzgjedhur . Kontrata është dy vjeçare dhe kjo kompani është e pajisur mirë për kryerjen e punëve dhe shërbimeve . Vitin e kaluar jemi ndarë mirë me punët që janë kryer , por që edhe dimri ka qenë më i butë . Prioritet do i japim rrugëve më të rëndësishme e në viset malore do i shtojmë edhe kapacitetet tjera të makinerisë nëse paraqitet ndonjë emergjencë .Angazhimi ynë ka qenë edhe në pastrimin e përrrenjve dhe kanaleve atmosferike . Gjatë punës që bëjmë në rregullimin e trotuareve ne parashohim edhe trajtimin e ujërave atmosferike.

K.Sallahu: ndoshta ka qenë një fat i mirë që dimri vitin e kaluar nuk ka qenë i ashpër dhe e kemi kaluar mirë , por që edhe për kompaninë nuk kam ndonjë vërejtje për shërbimet që i ka bërë . A ekziston mundësia e shtimit të kapaciteteve të makinerisë nëse do të kemi një gjendje të jashtëzakonshme me pérkeqësim të situatës si pasojë e reshjeve të mëdha të borës .

R.Osmani: Kompania e ka të drejtën edhe të nënkontraktoj edhe me ndonjë kompani tjetër dhe besoj që do e kalojmë mirë çdo situatë që do të na paraqitet .

Kryetari: nuk e kemi testuar kompaninë në lidhje me kapacitetet e sajë por që në rast të paraqitjes të ndonjë sfide ne do kërkojmë edhe ndihmën e FSK-së dhe kompanitë tjera por edhe nga qytetarët me punë vullnetare .

F.Guri: propozoj që inspektorët komunal të janë në nivel të kryerjes së detyrave të tyre . Bizneset po e ngritin nivelin e ndërtimit të objekteve të tyre por që nuk po marrin masa në trajtimin e dhe rregullimin e vijave kulluese të ujit si në magjistrale e poashtu edhe në rrugët lokale . Në magjistrale prej varrezave të dëshmorëve e deri në Kaçanik janë mbyllë të gjitha ato tunele që janë ndërtuar më herët dhe uji vërshon rrugën që krijon rrezikshmëri të vazhdueshme . Dihet se rruga magjistrale është nën kompetencat e nivelit qendrorë por që bizneset janë të komunës tonë . E njeta gjë është duke ndodhur edhe në rrugën Bob-Doganj . Është mirë që të bisedohet me këto biznese dhe të bëjnë një zgjidhje për trajtim të vijave kulluese të ujit .

Kryetari: Është shqetësim me vend dhe ne si komunë përmes inspektorëve do ta adresojmë çështjen e rrjedhjes së ujërave në magjistrale ndërsa sa i përket rrugëve

lokale ne do ti marrim masat me kohë. Jemi duke pritur miratimin e planit zhvillimor komunal dhe në këtë plan me siguri se janë paraparë edhe kriteret e ndërtimit të objekteve për rrerh rrugëve .

R.Osmani :Bizneset rrerh magjistralës krahas lejes së biznesit bëjnë edhe pagesë për çasje në rrugë në ministri . Sa i përket rrugës Bob-Doganaj ne jemi duke punuar në trasimin e sajë me kadastër dhe ka pasur devijime , kështu që po kemi probleme me pronarët e tokave dhe e vëtmja zgjidhje është nëse bëhet shpronësimi i asaj pjese të tokës ku neve na duhet të intervenojmë .

K.Sallahu: është bërë një punë e mirë në rregullimin e trotuarit në rrugën Bob-Doganaj ngase është rritë siguria qytetare . Problemet në këtë rrugë kanë filluar të shfaqen pasi që disa pjesë janë mbuluar me dhe dhe vijat e ujit kan filluar të dalin në rrugë . Kjo rrugë do ta ketë rëndësinë e rrugës magjistrale dhe është mirë që me kohë të merren masa që gjatë ndërtimeve të kushtëzohen pronarët për rregullimin edhe të kanaleve të ujërave .

4.Të ndryshme

Sh.Abazi: është hera e gjashtë që zhveshtoret e stadiumit po demolohen por që herën e fundit nuk është bërë ndonjë dëm . Për herat e kaluara ne jemi në një proces gjyqësor me disa persona që janë të dyshuar për dëmin që kan bërë por që kërkoj që të ndërmirret diçka që kjo dukuri mos të përsëritet . Një shqetësim tjetër kisha me ngritë rrerh pranisë të qenëve endacak nëpër rrugë të qytetit që po paraqesin rrezik për qytetarët në përgjithësi .

Kryetari : është lajm i mirë që disa prej dëmtuesve jan kapur nga policia në lidhje me demolimin e objektit te stadiumi i qytetit dhe gjykata është duke u marrë me procedurat e mëtutjeshme . Ne mundë të mendojmë për vendosjen e kamerave të sigurisë në këtë objekt që nuk do të ket kosto të madhe .Sa i përket qenëve endacak , kjo është një sfidë në gjitha komunat . Janë përdorë metoda të ndryshme kastrimi por që nuk kanë dhënë ndonjë efekt . Përpjekjet për ta tejkular këtë sfidë janë duke u bërë në nivelin qendrorë .

R.Osmani : zotimet e AVUK-ut se do ta përmirësojnë gjendjen lidhur me qenët endacak si duket kanë dështuar edhe pse iu është ndarë një buxhet i konsiderueshëm të mjeteve financiare nga Qeveria . Në një takim që kam marrë pjesë është kërkuar që ky problem të zgjidhet në nivel vendi .Pa u marrë një vendim për eliminimin e qenëve që vërehen me sëmundje e që numri është i madh dhe me arrit në nivel të qenëve endacak të menaxhueshëm , kjo situatë vështirë se do të përmisohet . Problem po na shkaktojnë edhe qenët me pronarë të cilët po shumohen dhe po shëndrrohen në qen endacak . Me këtë problematikë në të ardhmen do të merret edhe inspektorati .

F.Qaka: Propozoj që takimi i radhës i KKSBB-së të mbahet në dhjetë ditshin e parë të muajit dhjetorë dhe komisioni për përpilimin e Planit të Punës deri në këtë kohë të përgatisin këtë plan , të miratohet në KKSBB dhe të përcillet në Kuvend Komunal për aprovim me qëllim që në muajt e parë të vitit 2021 të kemi mbledhjen e parë për këtë vit .

REKOMANDIMET:

- 1.Të zbatohen me përpikëri masat ndaj virusit COVID-19**
- 2.Krahas masave ndaj virusit COVID-19 të mos anashkalohen edhe masat ndaj veprave tjera jo ligjore .**
- 3.Të zbatohen kriteret e ndërtimit afër rrugëve .**
- 4.Një kujdes i shtuar që gjatë ndërtimeve të objekteve afër rrugëve të rregullohen edhe kanalet e ujërave atmosferik .**
- 5.Të vendosen dhe të kontrollohen kamerat e sigurisë në çdo vend që është e arsyeshme vendosja e tyre .**
- 6.Angazhim edhe më i madh i inspektorëve komunal në parandalimin e çdo vepre jo ligjore .**

Pas këtyre diskutimeve Kryetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka